

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

UNMIK/REG/2005/15
16 mars 2005

RREGULLORE NR. 2005/15

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/19 MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për themelimin e degës ekzekutive të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 4 mars 2002 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 dhe në pritje të shpalljes së kësaj Rregulloreje, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/50 të datës 2 dhjetor 2004 për themelimin e ministrive të reja dhe të posteve të zëvendëskryeministrit e të zëvendësministrave në degën e ekzekutivit,

Pas konsultimeve me Qeverinë,

Me qëllim të ndryshimit të neneve 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 për të pasqyruar ndryshimet në kuadër të strukturës organizative të degës së ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe me qëllim të përcaktimit të përgjegjësisë e të funksioneve të ministrive të reja,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshim

Duke filluar nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19 ndryshohet si në vijim:

- (a) Shtohen nenet e reja 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 dhe 1.2.4 përmbajtja e të cilëve është si në vijim:

1.2.1. Në kuadër të degës së ekzekutivit mund të themelohen postet e zëvendëskryeministrit dhe të zëvendësministrave. Zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat emërohen nga Kryeministri pas miratimit të kandidatit në fjalë nga Kuvendi i Kosovës. Kandidatët për këto poste zgjedhen dhe i propozohen Kuvendit nga Kryeministri pas konsultimeve të nivelit politik dhe në bashkërendim me PSSP-në. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në mënyrën e cila i merr parasysh kërkesat për sigurimin e përfaqësimit të barabartë të serbëve të Kosovës dhe të bashkësive të tjera joshumicë, si dhe të përfaqësimit gjinor. Detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendëskryeministrit caktohen nga kryeministri dhe detyrat e përgjegjësitë e zëvendësministrit caktohen nga ministri përkatës, pas miratimit nga Qeveria.

1.2.2 Në rast se Kryeministri vdes, jep dorëheqje apo është përkohësisht i paaftë për ushtrimin e pushtetit apo të detyrave të tij, zëvendëskryeministri ushtron pushtetin dhe detyrat e tilla derisa paaftësia të pushojë së ekzistuari ose derisa të zgjedhet Kryeministri në përputhje me nenin 9.3.8 të Kornizës Kushtetuese.

1.2.3 Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij të rregullta, zëvendëskryeministri, mes tjerash, i ndihmon kryeministrit në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë, merr pjesë në hartimin e vendimeve dhe të akteve të tjera që rregullojnë aktivitetet e Zyrës së Kryeministrit dhe të Qeverisë, i mbikëqyrë aktivitetet e organeve operative të Qeverisë në bashkërendim me Kryeministrin dhe siguron zbatimin e përgjegjësive dhe funksionet të cilat u janë besuar organeve të tilla.

1.2.4 Nëse ministri përkohësisht bëhet i paaftë t'i kryejë detyrat e tij, funksionet e ministrit ushtrohen nga zëvendësministri, por nëse ai nuk është i lirë, atëherë funksionet ushtrohen nga një zyrtar i lartë i ministrisë i caktuar nga ministri.

- (b) Neni 1.4 ndryshohet si në vijim:

1.4 Kryeministri mund të ndihmohet nga më së shumti dymbëdhjetë këshilltarë dhe secili ministër mund të ndihmohet nga më së shumti gjashtë këshilltarë, të cilët kanë statusin e të emëruarve politikë dhe nuk janë anëtarë të

shërbimit civil. Posti apo postet e këshilltarëve të autorizuar sipas këtij neni mund t'i ndahen zëvendëskryeministrit nga Kryeministri dhe zëvendësministrave nga ministri përkatës.

(c) Neni 2 ndryshohet si në vijim:

Kabinet i Kryeministrit

2.1 Kabineti i Kryeministrit ka një sektor që përfshin këshilltarët politikë të cekur në nenin 1.4 dhe, përveç kësaj, përfshin njësitë organizative të mëposhtme që bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në shtojcën I të kësaj Rregulloreje:

(a) Zyra e zëvendëskryeministrit;

(b) Sekretaria për bashkërendimin e Qeverisë;

(c) Zyra për shërbime juridike;

(d) Zyra për informim publik;

(e) Zyra këshilldhënëse për qeverisje të mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta dhe për çështje gjinore;

(f) Zyra për bashkërendimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të dialogut rajonal;

(g) Zyra për siguri publike;

(h) Zyra për procese të integrimeve evropiane dhe

(i) Komisioni për emërime të larta politike.

Ministritë e tjera

2.2 Themelohen ministritë e poshtëshënuara që bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në shtojcat përkatëse të kësaj Rregulloreje:

(a) Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (shtojca II);

(b) Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë (shtojca III);

(c) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (shtojca IV);

(d) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve (shtojca V);

(e) Ministria e Shëndetësisë (shtojca VI)

- (f) Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (shtojca VII);
- (g) Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (shtojca VIII);
- (h) Ministria e Shërbimeve Publike (shtojca IX);
- (e) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (shtojca X);
- (j) Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (shtojca XI);
- (k) Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit (shtojca XII);
- (l) Ministria e Energjetikës dhe e Minierave (shtojca XIII) dhe
- (m) Ministria e Pushtetit Lokal (shtojca XIV).

Neni 2
Shfuqizimi

Nëpërmjet kësaj shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/50.

Neni 3
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 mars 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca I

Kabineti i Kryeministrit

Kryeministrit do t'i ndihmojë një sektor i cili përfshin këshilltarë politikë sipas zgjedhjes së tij apo të saj. Ky sektor do të jetë përgjegjës për t'i ofruar ndihmë Kryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së Qeverisë dhe për bashkërendimin e punës së saj.

Pas konsultimeve me Qeverinë, Kryeministri mund të emërojë një këshilltar politik për të shërbyer si sekretar i Qeverisë. Sekretari i Qeverisë do të jetë përgjegjës që t'i ofrojë ndihmë Kryeministrit në bashkërendimin e punëve të Qeverisë dhe në dhënien e përkrahjes administrative në mbledhjet e Qeverisë, siç është paraparë në pjesën B të mëposhtme.

Përveç tjerash, Kabineti i Kryeministrit përfshin njësitë vijuese organizative:

A. Zyrën e zëvendëskryeministrit

Zyra kryen funksionet sipas kërkesës lidhur me ofrimin e përkrahjes për zëvendëskryeministrin gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të caktuara për të në përputhje me këtë Rregullore. Funksionet e Zyrës miratohen nga Kryeministri.

B. Sekretaria për bashkërendimin e punëve të Qeverisë

Sekretaria për bashkërendim:

- (i) Ofron përkrahje logjistike dhe analitike për Kryeministrin në mbledhjet javore të Qeverisë dhe të sekretarive të përhershme, si dhe në mbledhjet tjera të ministrave dhe siguron që Kryeministri dhe ministrat të kenë të gjitha informatat dhe analizat e nevojshme gjatë marrjes së vendimeve;
- (ii) Bashkërendon krijimin dhe zbatimin e politikave mes ministrave;
- (iii) Bashkërendon planifikimin e punës së Qeverisë dhe përcjelljen e zbatimit të vendimeve të Qeverisë;
- (iv) Bashkërendon marrëdhëniet e Qeverisë me Kuvendin e Kosovës në bashkëpunim me Presidencën, me Sekretarinë dhe me Zyrën për shërbime juridike të Kuvendit dhe
- (v) Bashkërendon marrëdhëniet e Qeverisë me UNMIK-un, përpos çështjeve në kuadër të përgjegjësi të bashkërenduesit për standarde.

C. Zyra për shërbimet e ndihmës juridike

Zyra:

- (i) Ofron udhëheqje juridike, shërbime këshillimore dhe ekspertizë për degën e ekzekutivit dhe për institucionet e tjera të vetëqeverisjes dhe
- (ii) Shqyrton të gjitha projektligjet që dega e ekzekutivit ia dorëzon Kuvendit për të garantuar pajtueshmëri me ligjin në fuqi në konsultim me Zyrën këshilldhënëse për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore dhe me zyrat e ministritë tjera, sipas rastit.

D. Zyra e informimit publik

Zyra:

- (i) Siguron qasje publike dhe transparencë për punën e degës së ekzekutivit, duke u ofruar informata dhe dokumente opinionit publik dhe mediave;
- (ii) Informon publikun për punën dhe vendimet e degës së ekzekutivit me anë të konferencave dhe të lëshimit të kumtesave për shtyp;
- (iii) Kujdeset që pozita e degës së ekzekutivit të përfaqësohet në shpalljet publike, në fushatat e informimit publik, në kumtesat e shtypit dhe në paraqitjen në media të anëtarëve të degës së ekzekutivit përmes bashkërendimit me organet brenda degës së ekzekutivit dhe
- (iv) Mban lidhje me shtypin lokal dhe ndërkombëtar për çështjet që i takojnë degës së ekzekutivit.

E. Zyra këshilldhënëse për qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështje gjinore

Zyra:

- (i) Mbikëqyr dhe këshillon ministrat në sferat e qeverisjes së mirë, në të drejtat e njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore;
- (ii) Krijon politikën e veprimit dhe nxjerr urdhëresa në sferën e qeverisjes së mirë, në sferën e të drejtave të njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore;

- (iii) Shqyrton projektregulloret e përgatitura nga dega e ekzekutivit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë në bashkëpunim me Zyrën e shërbimeve për ndihmë juridike dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- (iv) Shqyrton politikën e veprimit të Degës së ekzekutivit, procedurat dhe praktikat e veprimit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi, me praktikat e qeverisjes së mirë dhe mundësitë e barabarta dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- (v) Ndiemon në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të nxitur vetëdijësimin e popullatës mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, transparencën e qeverisjes, barazinë gjinore, mundësitë e barabarta dhe parimet tjera bazë të qeverisjes demokratike;
- (vi) Konsultohet me përfaqësuesit e bashkësisë dhe sipas nevojës krijon organe këshillëdhënëse për shqyrtimin e qeverisjes së mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësitë e barabarta dhe për çështjet gjinore.
- (vii) Ndiemon zhvillimin e politikave të barazisë gjinore dhe punon për avancimin e statusit të gruas në bashkëpunim me shoqërinë civile;
- (viii) Përcjell aktivitetet kundër mashtrimit dhe korrupsionit në Degën e ekzekutivit dhe nxit vetëdijësimin kundër mashtrimit;
- (ix) Përkrah vendimmarrjen demokratike dhe konsultimin e gjerë brenda Qeverisë;
- (x) Inkurajon pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje,
- (xi) I lëshon deklaratat e rekomandime Kryeministrit dhe ministrive të tjera përkatëse dhe
- (xii) Shqyrton, sipas nevojës, dosjet dhe dokumentet e Qeverisë që janë në sferën e funksioneve dhe përgjegjësi të Zyrës, pas dhënies së autorizimit nga Kryeministri.

F. Zyra për bashkërendimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për dialogun rajonal

Zyra i kryen përgjegjësitë dhe funksionet e saj në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2004/7 të datës 22 prill 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.

G. Zyra për sigurinë publike

Zyra i kryen përgjegjësitë dhe funksionet e saj në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2004/16 të datës 30 qershor 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.

H. Zyra për procese të integrimeve evropiane

Zyra i kryen përgjegjësitë dhe funksionet e saj në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2004/18 të datës 6 korrik 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.

I. Komisioni për emërime të larta politike

Komisioni:

- (i) Organizohet dhe funksionon në pajtim me rregullat dhe procedurat e punës që do të përcaktohen në një rregullore të mëvonshme;
- (ii) Kryesohet nga Kryeministri dhe për anëtarë të vet do të ketë:
 - (a) Ministrin e Shërbimeve Publike;
 - (b) Ministrin të cilit kandidati i emëruar do t'i shërbejë;
 - (c) Dy ministra nga komunitetet joshqiptare të Kosovës;
 - (d) Tre qytetarë eminentë të Kosovës që do t'i emërojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe
 - (e) Tre anëtarë ndërkombëtarë që do t'i emërojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm;
- (iii) Ka shërbime të sekretarisë që i siguron Ministria e Shërbimeve Publike;
- (iv) Cakton:
 - (a) Sekretarët e përhershëm të ministrive;
 - (b) Nëpunësit kryesorë ekzekutiv të agjencive ekzekutive dhe

- (c) Poste të tjera për të cilat mund të vendosë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe
- (v) Në konsultim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm i shkarkon zyrtarët e mësipërm vetëm për shkak të paaftësisë së tyre profesionale, sjelljes së keqe apo pasi të jenë shpallur fajtorë për ndonjë vepër penale dhe të jenë dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë apo më shumë muajve.

Shtojca II

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë

Ministria:

- (i) Bashkërendon zhvillimin dhe siguron realizimin e balancuar të buxhetit vjetor për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (ii) Krijon buxhete shumëvjeçare dhe programe afatgjata për investime publike në bashkëpunim me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (iii) Bashkërendon me institucionet përkatëse për vetëqeverisje të përkohshme dhe, sipas nevojës, me donatorët multilateralë e bilateralë për çështjet që kanë të bëjnë me financimin nga donatorët dhe kontributet e dhuruara;
- (iv) Siguron përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve të donatorëve për qëllimet e dakorduara;
- (v) Kujdeset që të gjitha të ardhurat dhe burimet tjera të financimit nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, duke përfshirë dhe ndihmat financiare vullnetare të regjistrohen sipas rregullave buxhetore;
- (vi) Me shërbimin doganor të UNMIK-ut bashkërendon çështjet administrative dhe operative;
- (vii) Kryen analiza ekonomike dhe punë kërkimore;
- (viii) Regjistron dhe iu raporton institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes si dhe Këshillit Ekonomik e Fiskal mbi të dalurat dhe të ardhurat e buxhetit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes;
- (ix) Përcjell harmonizimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes me rregullat dhe procedurat në fuqi përkitazi me shpenzimet publike, duke përfshirë prokurimin publik pa paragjykim ndaj kompetencave të Zyrës së revizorit të përgjithshëm;

- (x) Përkrah aktivitetet kundër mashtrimit dhe korrupsionit në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, si dhe vetëdijësimin kundër mashtrimeve në përgjithësi dhe
- (xi) Në sektorin publik e privat siguron miratimin dhe zbatimin e standardeve të kontabilitetit në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare të kontabilitetit.

Shtojca III

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë

Minsitria:

- (ii) Krijon kushte kornizë për tregti, industri dhe punë komerciale;
- (iii) Krijon politikën e punës dhe zbaton legjislacionin për përkrahjen e konkurrencës së drejtë;
- (iv) Krijon politikën e punës dhe zbaton legjislacionin dhe programet për përkrahjen e ndërmarrjeve industriale dhe komerciale, veçmas të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- (v) Krijon politikën e punës për zhvillimin e sektorit privat;
- (vi) Krijon politikën e punës dhe zbaton programe për përkrahjen e tregtisë së jashtme;
- (vii) Krijon poitikën e punës dhe zbaton legjislacionin për të ndihmuar turizmin në Kosovë;
- (viii) Përkrah investimet në Kosovë veçmas përmes sigurimit të infomatave për investitorët potencialë, duke i kundërvënë investitorët e huaj me ata të vendit, duke i ndihmuar investitorët në marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme dhe duke përpiluar e publikuar të dhënat mbi investimet e huaja;
- (ix) Jep rekomandime për çështjet e privatizimit;
- (x) Krijon dhe përkrah programet për ruajtjen e energjisë;
- (xi) Inkurajon zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e minierave dhe
- (xii) Administron sistemin e regjistrimit të biznesit.

Shtojca IV

Minsitria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Minsitria:

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë.
- (ii) Përkrah një sistem arsimor jodiskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve;
- (iii) Ofron arsim joformal dhe arsim për të rriturit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rajonet e largëta dhe përkrah mundësitë e shkollimit të përjetshëm për të gjithë;
- (iv) Përpilon, zbaton dhe mbikëqyr format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe të menaxhimit të shkollave;
- (v) Përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet;
- (vi) Ndhmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore;
- (vii) Përkrah hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës.
- (viii) Ndërton një sistem gjithpërfshirës bibliotekar, i cili do të përfshijë bibliotekat e posaçme dhe ato shkollore;
- (ix) Përkrah një politikë gjithpërfshirëse për integrimin e personave të paaftë dhe të hendikepuar;
- (x) Përkrah pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkolle - komunitet në nivelin lokal.

Shtojca V

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve

Minsitria:

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për të përkrahur sektorin e kulturës, duke përfshirë programet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, avancimin e lidhjeve kulturore dhe formimin e klubeve kulturore, grupeve, shoqatave dhe shoqërive kulturore;
- (ii) Krijon politikën e veprimit dhe strategjitë për sektorin e rinisë, duke përfshirë identifikimin e grupeve specifike të rrezikuara, zhvillimin e programeve për shqyrtimin e nevojave të tyre dhe përkrahjen e klubeve, grupeve dhe shoqërive rinore;
- (iii) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për formimin dhe funksionimin e organizatave, shoqërive, klubeve dhe grupeve sportive;
- (iv) Kujdeset dhe ndihmon komunikimin dhe kontaktet mes personave dhe organizatave përmes aktiviteteve siç janë zhvillimi, përhapja dhe këmbimi i materialeve informative, kulturore, arsimore dhe materialeve të tjera;
- (v) Avancohet aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore si dhe lidhjet me anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore, duke përfshirë edhe ata që jetojnë përkohësisht ose përgjithmonë në Kosovë (banorë jorezidentë) dhe
- (vi) Mban lidhje me rrjetet e themeluara të jorezidentëve që trajtojnë nevojat kulturore të mërgimtarëve dhe të të kthyerëve.

Shtojca VI

Ministria e Shëndetësisë

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën dhe zbaton ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor;
- (ii) Koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi;
- (iii) Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
- (iv) Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- (v) Përcjell situatën e shëndetësisë dhe zbaton masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë;
- (vi) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie;
- (vii) Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin;
- (viii) Merr pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet shëndetësore;
- (ix) Inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë;
- (x) Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mbikëqyr shërbimet e kontrollit të cilësisë së ushqimit dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Shtojca VII

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën e punës dhe të mirëqenies sociale dhe zbaton legjislacionin në këto lëmi;
- (ii) Përkrah dhe zhvillon marrëdhëniet jodiskriminuese të punës dhe të punësimit duke marrë parasysh standardet e zbatueshme ndërkombëtare të punës;
- (iii) Përcjell gjendjen e punësimit dhe të mirëqenies sociale dhe propozon masa adekuate për të shtuar punësimin dhe për të zvogëluar papunësinë, si dhe për të përmbushur nevojat e ndihmës sociale;
- (iv) Përkrah politikën e veprimit dhe praktikën e punës e të mirëqenies sociale për mbrojtjen e familjeve dhe të miturve;
- (v) Vendos standarde për siguri në punë dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- (vi) Udhëheq dhe mbikëqyr institucionet administrative të punës dhe të mirëqenies sociale, siç është Enti i Kosovës për Punësim, dhe bashkëpunon me komunat, zyrat e mirëqenies sociale dhe institucionet tjera të përfshira në zbatimin e politikës së punës dhe të mirëqenies sociale;
- (vii) Siguron programe aftësimi për të papunësuarit dhe punëkërkuesit për të përmirësuar mundësitë e tyre të punësimit;
- (viii) Nxit dialogun shoqëror dhe pjesëmarrjen e partnerëve shoqërorë në bashkëbisedime të tilla (sindikatat dhe punëdhënësit dhe organizatat e tyre) me komunitetet;
- (ix) Inkurajon zhvillimin e iniciativave dhe aktiviteteve të komunitetit përkitazi me punësimin dhe mirëqenien sociale;
- (x) Konvokon këshillin trepalësh këshillëdhënës të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe të organizatave të punëdhënësve e punëtorëve për konsultime rreth punës për mirëqenie sociale e për politika të tjera ekonomike dhe përfaqëson institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në këtë këshill;
- (xi) Siguron ndihma financiare nga mjetet e akorduara për familjet dhe individët nevojtarë;
- (xii) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me punën dhe me mirëqenien sociale në përgjegjësinë e kësaj Ministrie;

- (xiii) Përkrah zhvillimin e sistemit të sigurimit social, duke përfshirë edhe papunësinë dhe sigurimin pensional.

Shtojca VIII

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën e punës dhe zbaton ligjet për sigurimin e shërbimeve dhe objekteve në sektorin e transportit rrugor, transportit publik rrugor, postës, telekomunikacionit dhe teknologjisë informative;
- (ii) Identifikon dhe vendos kritere, specifika teknike dhe standarde të zbatueshme adekuate të cilave duhet t'u përmbahen ofruesit e shërbimeve dhe infrastruktura; mbikëqyr këtë punë dhe nëse është e nevojshme bën inspektimin e kontrollimin dhe informon për pasojat e mospërmbushjes së këtyre kushteve;
- (iii) Mbikëqyr dhe përcjell punën e sektorëve dhe prezenton masa adekuate për të tejkaluar vështirësitë dhe problemet e shërbimeve;
- (iv) Krijon politikën e punës dhe propozon programe për promovimin e ndërmarrjeve nëpër sektorë, duke përfshirë edhe strategjitë për ristrukturim dhe për investime kapitale;
- (v) Merr pjesë në zhvillimin e fushatave për informim publik dhe të projekteve të tjera përkrahëse për të ngritur vetëdijësimin publik dhe reagimin ndaj çështjeve sektoriale;
- (vi) Në sektorin e telekomunikacionit shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që pëfshijnë tarifat dhe taksat, cilësinë e shërbimeve dhe të standardeve teknike, krijon politikën e punës për promovimin e konkurrencës dhe shqyrton nevojat e konsumatorëve;
- (vii) Në sektorin e postës shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që pëfshijnë tarifat, cilësinë e shërbimeve dhe standardet teknike;
- (viii) Në sektorin e teknologjisë informative përkrah teknologjinë informative dhe të inovacioneve, p.sh. tregtinë elektronike, përkrah qasjen në teknologji dhe nxit zhvillimin e sistemeve të aftësimin në teknologjinë e informatikës;
- (ix) Në sektorin e infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, siguron financimin dhe organizon dhënien e koncesioneve sipas nevojës; mbikëqyr financimin dhe menaxhimin e infrastrukturës rrugore duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe zhvillimore përkitazi me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike, kontrollon gjendjen e rrugëve, si dhe mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor;

- (x) Në sektorin e transportit rrugor të personave dhe mallrave mbikëqyr procedurat e licencimit të ndërmarrjeve, automjeteve dhe shoferëve; u jep autorizime operative (itinerarin dhe intervalin kohor) në bazë të konkurrencës dhe mbështet sigurimin e shërbimeve humanitare dhe shërbimeve të tjera speciale dhe
- (xi) Mbikëqyr sigurinë e transportit, ndërmarrjen e veprimeve, hetimeve dhe masave të nevojshme dhe siguron që rreziku për jetë dhe dëmet tjera të zvogëlohen.

Shtojca IX

Ministria e Shërbimeve Publike

Kjo Ministri:

- (i) Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e politikës së punës për një shërbim civil shumetnik, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm;
- (ii) Zhvillon dhe koordinon zbatimin e politikës së punës për krijimin dhe aftësimin e kuadrave për shërbimin civil;
- (iii) Administron sistemin e pagesave dhe listën e pagave të shërbimit civil;
- (iv) Siguron shërbime të inxhinierisë dhe të menaxhimit të ndërtesave për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (v) Vendos standardet dhe shërbimet e teknologjisë informative që duhet përdorur nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe koordinon sigurimin e shërbimeve të teknologjisë informative në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (vi) Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e politikës së punës për sigurimin e shërbimeve të furnizimit në pajtim me rregullat dhe procedurat e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa;
- (vii) Ndhmon në administrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit të regjistrimit qendror civil dhe bazës së të dhënave;
- (viii) Ndhmon në administrimin e politikës së punës përkitazi me dokumentet civile, regjistrimin e automjeteve dhe OJQ-ve;
- (ix) Mbikëqyr mbledhjen, mirëmbajtjen, analizat dhe publikimin e statistikave zyrtare;
- (x) Kryen funksione në lëmin e çështjeve gjyqësore në pajtim me paragrafin 5.3 (b) – (m) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe
- (xi) Kryen funksione në lëmin e përgatitjeve civile për raste emergjente në pajtim me paragrafin 5.5 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme;

Shtojca X

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën dhe zbaton ligjet për zhvillimin e bujqësisë, duke përfshirë edhe bagëtinë dhe prodhimin e bimëve, zhvillimin rural dhe vendosjen e standardeve të cilave duhet përmbajtur;
- (ii) Lehtëson zhvillimin e skemës kreditore për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat;
- (iii) Krijon politikën për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetëmbajtjen, luftimin e zjarrit, parandalimin e zjarrit, dezinfektimin nga insektet dhe sëmundjet e ndryshme, licencimin për prerjen e drunjve dhe kontrollimin e gjuetisë dhe të peshkimit;
- (iv) Rregullon aktivitetet e gjuetisë dhe të peshkimit;
- (v) Mbikëqyr ofrimin e shërbimeve veterinarë, duke përfshirë ndër të tjera parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, të zoonozës dhe përmirësimin e cilësisë së kopeve dhe tufave të shpezëve;
- (vi) Krijon politikën në lëmin e ujitjes, duke përfshirë edhe projektet për planifikimin e ujitjes;
- (vii) Krijon politikën dhe zbaton ligjet përkitazi me shfrytëzimin e tokës bujqësore me qëllim të mbrojtjes së saj;
- (viii) Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr zbatimin e standardeve shëndetësore që ndërlidhen me bujqësinë, pylltarinë, qendrat për rritjen e peshqve dhe zhvillimin rural;
- (ix) Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve;
- (x) Mbikëqyr aktivitetet që synojnë zhdukjen e insekteve, parazitëve, sëmundjeve të bimëve apo shkaktarëve tjerë të shkatërrimit;
- (xi) Merr pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit që kanë të bëjnë me bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkimin dhe menaxhimin e resurseve të ujit dhe

- (xii) Ofron ndihmë në çështjet që ndërlidhen me veterinarinë, bën kontrollin fitosanitar dhe të cilësisë së kafshëve dhe të produkteve të kafshëve që kalojnë tranzit nëpër vendkalimet kufitare administrative dhe shtetërore, bën kontrollin e ushqimit dhe të lëndës së parë bujqësore, të bimëve dhe produkteve bimore.

Shtojca XI

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor

Kjo Ministri:

- (xi) Koordinon aktivitetet në sektorin e mbrojtjes së mjedisit për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për mbrojtjen e mjedisit;
- (xii) Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e mbrojtjes së mjedisit duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
- (xiii) Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- (xiv) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me mbrojtjen e mjedisit në përgjegjësinë e kësaj Ministrie;
- (xv) Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- (xvi) Krijon politikën, zbaton ligjet dhe mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin;
- (xvii) Merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet për mbrojtjen e mjedisit;
- (xviii) Mbikëqyr dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike, meqë ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- (xix) Inkurajon zhvillimin e arsimit mjedisor për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e mbrojtjes së mjedisit;
- (xx) Krijon politikën për menaxhimin e resurseve të ujit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

- (xxi) Përkrah zhvillimin, zbatimin dhe transferimin e teknologjive të pastra;
- (xxii) Në bashkëpunim me ministritë tjera përkatëse identifikon zonat që duhet mbrojtur për të mirën e popullatës, krijon politikën dhe zbaton masa për ruajtjen dhe administrimin e tyre dhe
- (xxiii) Siguron inkorporimin e planit hapësinor mbarëkosoar në politikën dhe programet e Qeverisë dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga autoritetet përkatëse.

Shtojca XII

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Kjo Ministri:

- (i) Zhvillon politika dhe promovon e zbaton ligje për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me kapitujt 3 dhe 4 të Kornizës Kushtetuese;
- (ii) Promovon krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim dhe siguron një qasje ndaj kthimit që bazohet në të drejta;
- (iii) Siguron udhëheqjen në ndërtimin e besimit, në aktivitetet për dialog dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe mbështet zbatimin e këtyre aktiviteteve;
- (iv) Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e një strategjie qeveritare për ndihmë që ju drejtohet komuniteteve dhe kthimeve dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e këtyre strategjive në të gjitha komunat;
- (v) Zhvillon apo menaxhon programe dhe mekanizma për të ndihmuar integrimin në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që aktualisht banojnë në Kosovë, si dhe për të siguruar kthimin e qëndrueshëm të të shpërngulurve dhe refugjatëve;
- (vi) Siguron se politika në nivel qendror dhe komunal përfshin dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë fushën e lirisë së lëvizjes, përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimit, punësimit dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe shërbime publike e komunale;

- (vii) Bën rekomandime dhe koordinon e monitoron aktivitetet e ministrive, komunave dhe autoriteteve të tjera që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer e sipas nevojës rishikon veprimtaritë, dosjet dhe dokumentet e këtyre organeve, nëse jepet autorizimi i Kryeministrit për këtë gjë;
- (viii) Mbikëqyr dhe mbështet përpjekjet e komunave për trajtimin e çështjeve të komuniteteve dhe kthimeve, duke përfshirë punën e komisioneve për ndërmjetësim, komisioneve për komunitete, zyrat komunale për komunitete dhe zhvillimin e zbatimit të strategjive komunale për kthim;
- (ix) Rishikon dhe iu ofron ndihmë ministrive të tjera në lidhje me procedurat dhe aktivitetet ekzistuese, sikurse edhe politikën e propozuara dhe projektligjet, për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre dhe të shpërngulurve dhe përputhjen e akteve legjislative të IPVQ-ve e rregulloreve të komunave me standardet relevante ndërkombëtare dhe me dispozitat e Kornizës Kushtetuese;
- (x) Koordinon me ministritë, komunat dhe autoritetet tjera për gjetjen e zgjidhjes për shpërnguljet dhe nevojat humanitare të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;
- (xi) Koordinon me ministritë, komunat dhe autoritetet tjera zbatimin e një strategjie për të drejtat e njeriut në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, të shpërngulurve dhe të kthyerve, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe grupeve tjera të ndjeshme;
- (xii) Mbikëqyr dhe mbështet kornizën operative për kthime për të siguruar një qasje që mbështetet apo bazohet në të drejta dhe që iu përgjigjet nevojave të personave të shpërngulur dhe bashkëpunimit me ministritë tjera, me agjencitë dhe OJQ-të e ndryshme gjatë këtij procesi;
- (xiii) Mbikëqyr përputhjen e akteve legjislative dhe politikave të ministrive tjera dhe autoriteteve lokale me Standardet për Kosovën dhe Planin për Zbatimin e Standardeve për Kosovën dhe merr rolin prijës në zbatimin e veprimeve sipas atij plani që ia cakton qeveria ministrisë;
- (xiv) Ndhmon në zhvillimin dhe në zbatimin e masave në fushën e informimit publik dhe të projekteve të tjera promovuese për ngritjen e vetëdijes publike përkritazi me të drejtat dhe interesat e komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer dhe
- (xv) Kryen detyra të tjera të përkufizuara në bazë të legjislacionit në fuqi.

Shtojca XIII

Ministria e Energjetikës dhe e Minierave

Kjo Ministri:

- (i) Në bashkëpunim të ngushtë me PSSP-në zhvillon politika, përgatit dhe zbaton ligje për zhvillimin e sektorit të energjetikës dhe minierave, veçanërisht me qëllim të arritjes së bashkimit më të mirë të mundshëm të vlerave ekonomike, shoqërore dhe të mjedisit;
- (ii) Siguron udhëheqje për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe bashkërendon punën e Qeverisë me UNMIK-un, me IPVQ-të dhe organet përkatëse rregullatore me qëllim të mundësimit të zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie për energjetikën dhe minierat në Kosovë. Në këtë kontekst veprimtaritë e ministrisë bashkërendohen me UNMIK-un, veçmas në lidhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e ndërlidhura që janë të rezervuara për PSSP-në;
- (iii) Në bashkërendim me PSSP-në bën promovimin dhe vepron si ndërlidhës në emër të Qeverisë për veprimtaritë që kanë për qëllim integrimin në tregjet rajonale të energjisë të formuara nga komuniteti i energjetikës në Evropën Juglindore, si dhe kryen veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me avancimin e përputhshmërisë dhe arritjes së standardeve evropiane në sektorin e energjetikës dhe të minierave;
- (iv) Përkrah një mjedis të favorshëm për investuesit në zhvillimin e sektorit të energjetikës dhe minierave dhe bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, PSSP-në dhe organet përkatëse rregullatore për të përcaktuar kushtet e përgjithshme për investime veçmas duke pasur parasysh stimulimet fiskale, duke përfshirë tatimet, fitimet dhe çështjet e qiradhënies në lidhje me sektorin e energjetikës dhe të minierave;
- (v) Në bashkërendim me UNMIK-un mbikëqyr dhe siguron bashkëpunimin në kuadër të Qeverisë për përgatitjen dhe zbatimin efektiv të projekteve në sektorin e energjetikës dhe të minierave të financuara nga donatorët ose institucionet financiare ndërkombëtare, duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Në këtë kontekst të caktohen projektet prioritare të realizueshme financiarisht në sektorin e energjetikës dhe të minierave;
- (vi) Miraton bilancet afatgjata dhe vjetore të energjetikës, mbledh dhe përpunon statistikën e energjetikës dhe të minierave dhe përditëson parashikimet e kërkesës për energji;

- (vii) Promovon veprimtari që kanë për qëllim zvogëlimin e ndotjes së mjedisit si rezultat i veprimtarive që lidhen me energjetikën dhe minierat;
- (viii) Në bashkëpunim me organet dhe institucionet përkatëse në mënyrë sistematike bën mbledhjen, arkivimin, kompilimin, përpunimin si dhe i vë në dispozicion të dhënat gjeoshkencore përkitazi me resurset gjeologjike të Kosovës dhe me kërkesë të Qeverisë i siguron raportet që i ka në dispozicion dhe vlerësimet e ekspertëve lidhur me çështjet gjeoshkencore;
- (ix) Promovon teknologji dhe programe efikase energjetike, përdorimin e arsyeshëm të energjisë dhe të resurseve minerare dhe promovon burimet e ripërtëritshme të energjisë;
- (x) Përkrah inspektoratet përkatëse në sektorin e energjetikës dhe të minierave në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tyre që u janë caktuar me ligj;
- (xi) Mbikëqyrë lëshimin e licencave dhe lejeve për veprimtarinë e minierave në Kosovë nga rregullatori i pavarur për miniera. Ministria mund t'i bëjë rekomandime PSSP-së nëse ajo mendon se ndonjë vendim i rregullatorit të pavarur për miniera nuk është në përputhje me politikat e miratuara për sektorin e minierave apo me ligjin në fuqi;
- (xii) Merr informata prej rregullatorit të pavarur për miniera lidhur me lëshimin e licencave dhe të lejeve për veprimtarinë e minierave në Kosovë. Qeveria mund të kërkojë sqarime plotësuese lidhur me këto licenca dhe leje;
- (xiii) Përkrah dhe promovon zhvillimin e resurseve njerëzore me aftësi të larta dhe profesionale në sektorin e energjetikës dhe të minierave;
- (xiv) Merr pjesë në zhvillimin e fushatave për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe reagimin ndaj çështjeve përkitazi me sektorin e energjetikës dhe të minierave;
- (xv) Në bashkërendim me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në përputhje me Kornizën Kushtetuese dhe ligjet në fuqi merr pjesë në mbikëqyrjen e NP-ve dhe NSH-ve në sektorin e energjetikës dhe të minierave dhe
- (xvi) I propozon Qeverisë kandidatët për përfaqësues të Qeverisë në këshillat mbikëqyrëse të NP-ve dhe NSH-ve në sektorin e energjetikës dhe të minierave.

Shtojca XIV

Ministria e Pushtetit Lokal

Kjo Ministri:

- (i) Zhvillon politika dhe zbaton legjislacion për vetëqeverisje efikase komunale;
- (ii) Promovon dhe afirmon të drejtën e organeve lokale për vetëqeverisje në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
- (iii) Kryen funksione në fushën e administratës lokale ashtu si janë dhënë në paragrafin 5.2 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e që janë:
 - (a) Përkrahja e bashkëpunimit ndërkomunal;
 - (b) Promovimi i zhvillimit të shërbimit civil komunal profesional, duke i marrë parasysh përgjegjësitë e Ministrisë së Shërbimeve Publike;
 - (c) Ndihmë komunave në zhvillimin e buxheteve dhe sistemeve të tyre të menaxhimit të financave të mëvetësishme;
 - (d) Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimeve komunale;
 - (e) Identifikimi i mënyrave dhe i mjeteve për aktivitete trajnimi për komunat;
 - (f) Ndihmë komunave që aktivitetet e tyre të bëhen transparente para opinionit;
 - (g) Ofrimi i këshillave dhe i udhëzimeve ligjore për komunat;
 - (h) Bashkërendimi i aktiviteteve të agjencive ndërkombëtare dhe i organizatave joqeveritare që kanë të bëjnë me komunat dhe
 - (i) Mbikëqyrja e komunave gjatë zbatimit të përgjegjësive dhe kompetencave të bartura tek komunat në bazë të strukturave organizative të dalura nga zgjedhjet komunale në tetor të viti 2000, si dhe i përgjegjësive e kompetencave të bartura në ndërkohë,
- (iv) Bashkërendimi me ministritë gjegjëse sektoriale për ofrimin efektiv të shërbimeve publike të kontrolluara nga niveli qendror, ku përfshihen resurset

njerëzore dhe financiare për t'i plotësuar nevojat e të gjitha komuniteteve dhe për t'u siguruar qasje në të mirat dhe shërbimet qenësore themelore;

- (v) Bashkërendimi me Ministrinë e Financave për t'u siguruar se administratat komunale marrin mjetet buxhetore që u duhen për t'i ushtruar përgjegjësitë e veta, duke përfshirë investimet publike;
- (vi) Kontribuon në zbatimin e ligjit për barazi gjinore në nivelin lokal, ndan resurse adekuate financiare dhe njerëzore për t'i përkrahur zyrtarët komunal që merren me çështje gjinore, me trajtimin e pabarazive gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore në krijimin e politikave të qeverisjes lokale dhe në ofrimin e shërbimeve;
- (vii) Në bashkërendim me PSSP-në i trajton çështjet lidhur me përbërjen e njësive të qeverisjes lokale dhe të kufijve të tyre;
- (viii) Krijon politika për formën e vendimmarrjes dhe ndërmarrjes së nismave të lira për çështje të interesit të veçantë për banorët e lokalitetit komunal të caktuar dhe
- (ix) Kryen detyra të tjera të përkufizuara në bazë të legjislacionit në fuqi.